

## **Hapet thirrja për aplikime për studentët në Universitetin Cankiri Karatekin, në Turqi, në kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Cankiri Karatekin, në Turqi, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.

<https://international.karatekin.edu.tr/en>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;

- Master;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (04.10.2021 - 21.01.2022);

- Master (04.10.2021 - 21.01.2022);

Studentët duhet të kryejnë regjistrimin online në linkun:

[http://onkayit.karatekin.edu.tr/erasmus\\_student](http://onkayit.karatekin.edu.tr/erasmus_student)

\* Studentët e vitit të tretë Bachelor dhe studentët e vitit të dytë Master nuk mund të aplikojnë.

### **Fushat e studimit:**

-Kimi (për studentët e nivelit Master);

-Biologji (për studentët e nivelit Master);

-Matematikë (për studentët e nivelit Bachelor dhe Master);

-Shkenca Polotike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (për studentët e nivelit Master);

-Administrim biznesi (për studentët e nivelit Master).

Për më shumë informacion referohuni linkut:

<https://bbs.karatekin.edu.tr/AkademikBirimler.aspx?birim=15>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (275 EUR)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze / turke, në varësi të gjuhës në të cilën do të kryhet shkëmbimi);
- Kopje e Pasaportës;
- Foto;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose turke);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose turke);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze / turke;
- Application form, sipas linkut:

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/ERASMUS-APPLICATION-FOR-STUDENT.doc>

- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht / Turqisht);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti kryen ndryshime gjatë mobilitetit, duhet të veprojë po njësoj me firmosjen në pjesën “During mobility”.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/STUDENTS-Learning-agreement\\_Before-Mobility.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/STUDENTS-Learning-agreement_Before-Mobility.docx)

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Master:**

- CV (në gjuhën angleze / turke, në varësi të gjuhës në të cilën do të kryhet shkëmbimi);
- Kopje e Pasaportës;
- Foto;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / turke);

- Diplomë Bachelor;

- Listë notash Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / turke);

- Listë notash Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / turke);

- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);

- Application form, sipas linkut:

<https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/ERASMUS-APPLICATION-FOR-STUDENT.doc>

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht / Turqisht);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti kryen ndryshime gjatë mobilitetit, duhet të veprojë po njësoj me firmosjen në pjesën “During mobility”.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/STUDENTS-Learning-agreement\\_Before-Mobility.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/STUDENTS-Learning-agreement_Before-Mobility.docx)

**Afati për aplikim:** 31 Maj 2021.

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!